



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 21/02/2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18/02/2022 të parashtruar nga *Grupi Operatorëve ekonomik GASHI EG SH.P.K. & EKO-DRINIA SH.P.K.* rr - Qerim Banulla, nr – 16 Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit**, me numër identifikues: 613-21-9843-2-2-1 Nr i brendshëm 613 021 095 221.

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga *Grupi Operatorëve ekonomik GASHI EG SH.P.K. & EKO-DRINIA SH.P.K.* rr - Qerim Banulla, nr – 16 Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit**, me numër identifikues: 613-21-9843-2-2-1.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, për K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A., Bill Clinton, 10000, PRISHTINË, të publikuar me datë: 15/02/2022. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi Operatorëve ekonomik GASHI EG SH.P.K. & EKO-DRINIA SH.P.K. rr - Qerim Banulla, nr – 16 Lipjan, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit**, me numër identifikues: 613-21-9843-2-2-1, me datë 18/02/2022, lidhur me aktivitetin e lartëpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 21/02/2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e ankuesit janë të pa bazuar :

Pretendimi i parë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë "c). Kamion (cisternë) special me mekanizim komplet (thithje, de bllokim) për pastrim dhe de bllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik (min 1 cope)".

Gjatë vlersimit komisioni vlerësues ka kërkuar sqarim nga O.E. rekomanduar për kontratë për këtë pajisje dhe si konfirmim ka marrë fotografinë e kamionit që është adekuat sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit që dmth ky pretendim nuk qëndron dhe të bashkangjitur me këtë kërkesë do t'i keni librezën dhe fotografitë e pajisjes së kontestuar.

Pretendimi i dytë:

"Një inxhinier master apo bachelor i diplomuar i Komunikacionit i njëjti të jetë i caktuar nga OE edhe si menaxher për këtë projekt, minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. -Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit për këtë projekt i nënshkruar dhe vulosur nga OE. Për stafin profesional të dëshmohej me CV dhe diplome, Për të gjithë Stafin kërkohen kontratat e punës ose para kontratë për këtë projekt." OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se i njëjti në lidhje me kërkesën e lartcekur ka prezantuar në ofertë si projekt menaxher z. Enver Kadriun me të cilin ka lidhur kontratë, mirëpo nëse analizohet kontrata në tërësi shihet qartë se kjo kontratë është e lidhur vetëm për 4 muaj.

Edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye kontrata me ing e cekur është me mundësi vazhdimi dhe me nënshkrim të kontratës sigurisht se kjo kontratë do të vazhdohet me ing e cituar apo një ing me kualifikime të njëjta dhe për këtë do të kujdeset menaxheri i kontratës gjatë implementimit të kontratës.

Pretendimi i tretë:

O. E i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm edhe për faktin se tek përshkrimi i çmimeve përkatësisht tek pozicioni 5.1- Rrugët në kategorinë e (I-rë) dhe të (II-të) që kanë kanalizim tek kolona B nuk ka vendosur fare çmim. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 41 paragrafi 15 i RRUOPP-së, pasi që me këtë nen është e përcaktuar shumë qartë se në momentin që OE ofron çmim prej 0.00 €, tenderit duhet të refuzohet pasi që nuk janë të pranueshme dhuratat.

Edhe ky pretendim nuk qëndron sepse te çmimi njësi është faktë që shihet që çmimi është zero (0) por jo 0.00 siq e keni cekë që dmth mungojnë numrat pas presjes dhjetore por te pozicioni Çmimi 1 herë në 3.5 muaj kemi shumë prej 49€ që dmth edhe te çmimi njësi kemi një vlerë e që pas llogaritjes del se ajo vlerë është 0.07€ por vetëm te çmimi njësi mungojnë vlerat pas presjes dhjetore.

Pretendimi katërt:

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm edhe për faktin se në ofertë ka prezantuar deklaratën nën betim, deklaratën për specifikat teknike të nënshkruar nga një person i paaautorizuar dhe i njëjti në Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit nuk figuron që është pronar apo krye shef ekzekutiv siq ka pretenduar OE i rekomanduar për kontratë.

Edhe ky pretendim nuk qëndron sepse te ndërmarrjet publike nuk ndërrohet certifikata e biznesit sa herë që ndërrohen drejtorët.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.



Bekim Shabani

Bekim Shabani
Drejtor i drejtorisë së Prokurimit